REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 846/20
Datë/Datum. 23.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: SHSKUK - SHËRBIMI SPITALOR KLINIK UNIVERZITARE I KOSOVËS

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr1 i prokurimit	**701/20/4188/1-2-1**
Nr i brendshëm	**701/20-222-121**

Sa i përket tenderit për: Furnizim me ushqim pluhur për foshnje, LOT 1

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

SOLUTION D sh.p.k.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Ekrem Rexha nr. 28
(Adresa)

Prishtine — ***10000***
(Vendi) — *(Kodi postar)*

038 233 233 — ***038603524***
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Driton Sanaja
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

sales@solutiond.net
(Adresa elektronike)

21.10.2020
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

SH. P. K. Solution ADMINISTRATA PRISHTINË

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë me dt. 06.08.2020 Afati i fundit për dorëzimin e ofertave me dt. 28.08.2020 Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 02.10.2020 Kërkesa për rishqyrtim me dt:07.10.2020 Vendimi i AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim dt. 14.10.2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 64 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar ne me dt. **02.10.2020** përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me vendimin e AK-së, me letër standarde për tenderuesin e eliminuar, ndërsa ka rekomanduar për kontratë OE **Besim E. Bislimi B.I** për Lot 1, ndërsa ka anuluar aktivitetin e prokurimit për Lot 2 dhe 3.

Fillimisht ju sqarojmë se ne kemi bërë kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimit të AK-së të dt.**22.09.2020,** ku ne jemi shpallur si tenderues i pasuksesshëm ndërsa e ka rekomanduar për kontratë OE Union sh.p.k, ndërsa pas parashtrimit të kërkesës për rishqyrtim nga ana jonë, AK-ja e ka aprovuar kërkesën tonë dhe e ka anuluar njoftimin mbi vendimin e lartcekur.

Ndërsa tani në njoftimin mbi vendimin e AK-së jemi shpallur si tenderues të eliminuar ku në arsyen e eliminimit e AK-ja e ka cekur se ne *nuk i plotësojmë të gjitha specifikimet teknike të specifikuara në dosje të tenderit dhe të njoftimit për kontratë.*

Ju sqarojmë se ky arsyetim i AK-së në lidhje me eliminimin tonë, nuk qëndron për faktin se në i plotësojmë të gjitha specifikimet teknike të specifikuara në FDT dhe te njoftimi për kontratë. Ndërsa faktin se ne i plotësojmë të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë e ka vërtetuar edhe vetë AK-ja në njoftimin mbi vendimin e dt.22.09.2020, ku na ka shpallur si tenderues të pasuksesshëm.
Pra nëse ne do të ishim tenderues i papërgjegjshëm AK-ja do ti kishte cekur arsyet për papërgjegjshmërinë tonë mirëpo na ka shpallur tenderues të pasuksesshëm, fakt ky që tregon qartë se ne jemi OE i përgjegjshëm dhe është dashur të shpallemi tenderues i suksesshëm.
Ndërsa sa i përket pretendimit të AK-së se ne edhe pas pyetjeve për sqarime shtesë nuk kemi ofruar dëshmi shkencore për produktet e kërkuara ju sqarojmë se ky pretendim i AK-së nuk qëndron sepse ne i kemi ofruar te gjitha dëshmitë e kërkuara nga ana e AK-së, andaj duke u bazuar ne këtë fakt shihet qartë se ne i plotësojmë të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Gjithashtu ju sqarojmë se AK-ja e ka rekomanduar për kontratë një OE i cili është i papërgjegjshëm për arsyet si në vijim:

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se nuk i ka përmbushur të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë për faktin se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka fare ofruar Certifikatën ISO 9001 të kërkuar në FDT dhe tek njoftimi për kontratë , andaj edhe është dashur të shpallet si i papërgjegjshëm dhe jo të rekomandohet për kontratë nga ana e AK-së.

Po ashtu OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se Certifikatë të cilën e ka ofruar, pra HACCP certificate të cilën e ka prezantuar OE i rekomanduar për kontratë është ne emër te : Milchëirtschaftliche Industriegesellschaft Herford GmbH & Co.KG. Ndërsa produktet me të cilat ka ofertuar OE i rekomanduar për kontratë janë të kompanisë HIPP. Pra këto mospërputhje në mes të certifikatës së ofruar dhe produkteve me të cilat ka ofertuar OE i rekomanduar për kontratë e tregojnë qartë fakti se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se i mungon autorizimi i prodhuesit për pjesëmarrje në këtë tender, pra OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar as këtë kërkesë andaj është e habitshme se si ka mundur AK-ja të rekomandoj për kontratë një OE i cili nuk i plotëson të gjitha këto kërkesa të FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, mirëpo ky veprim i AK-së sikurse edhe në herën e parë ndërsa edhe tani po e tregon qartë diskriminimi që po na bëhet neve si OE i përgjegjshëm duke rekomanduar për kontratë OE të cilët janë të papërgjegjshëm dhe në këtë rast OE i rekomanduar për kontratë është edhe më i shtrenjtë se ne, mirëpo AK-ja nuk i ka marrë fare parasysh këto fakte që u përmendën më lartë.

Po ashtu OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar marrëveshjen e distribucionit ndërmjet kompanive, mirëpo që në atë marrëveshje nuk figurojnë fare të dhënat e prodhuesit si adresa, emaili etj, ashtu siç edhe është kërkuar në dosje të tenderit. Pra OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar as kërkesën e lartcekur, andaj edhe është dashur të shpallet i papërgjegjshëm dhe jo të rekomandohet për kontratë.

Duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se OE i rekomanduar për kontratë për Lot 1 është i papërgjegjshëm sepse nuk i ka plotësuar kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Gjithashtu pajtohemi me arsyet e AK-së për eliminimin e OE **Union SH.P.K** i cili është i papërgjegjshëm për arsyet që i keni cekur ju.

Ne me dt. 14.10.2020 kemi marrë përgjigje në kërkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kërkesa për rishqyrtim, mirëpo nuk ka dhënë asnjë përgjigje faktike dhe ligjore për refuzimin e kërkesë tonë për rishqyrtim.
Ne e kemi pranuar përgjigjen e AK-së, mirëpo ajo përgjigje nuk është kthyer në formën standarde të vendimit siç edhe duhet të kthehet përgjigja, mirëpo është kthyer në formë të emailit, veprim ky që tregon jo seriozitetin e AK-së në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit.

Në lidhje me refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim ku AK-ja e ka cekur se pretendimi ynë në lidhje me certifikatat "ISO 9001" nuk qëndron për faktin se certifikata "SGS" të cilën e ka ofruar OE i rekomanduar për kontratë i përfshinë të gjitha certifikatat. Mirëpo ne ju sqarojmë se ky arsyetim i AK-së është i pa bazuar dhe nuk qëndron për faktin se kërkesë e dosjes së tenderit tek kapaciteti teknik dhe profesional është specifikuar shumë qartë ***"Kërkesa 1. Certifikata ISO 9001!*** Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar ***"Evidenca 1. Te dëshmohet me kopjen e Certifikatës ISO 9001"***, pra shihet qartë se kërkesë e dosjes së tenderit nuk është kërkuar certifikata SGS mirëpo është specifikuar certifikata ISO 9001, andaj duke u bazuar në faktin e lartcekur shihet qartë diskriminimi që po i bëhet kompanisë tonë nga ana e AK-së dhe njëkohësisht favorizimi që po i bëhet OE të rekomanduar për kontratë.

Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar në ofertën e tij Certifikatën "Global Standard for Food Safety" qe nuk përmban ISO dhe HACCP, i cili OE edhe në ofertën e tij e ka bashkangjitur këtë certifikatë në emër të ISO dhe HACCP. Ndërsa AK-ja e ka rekomanduar për kontratë edhe pse OE i rekomanduar për kontratë për dy kërkesa të ndryshme ka ofruar certifikatën "Global Standard for Food Safety", pra kërkesat kanë qënë të specifikuara në dosje të tenderit mirëpo edhe pse është ofruar certifikata e lartcekur për dy kërkesa të ndryshme pra për ISO 9011 dhe për HACCP, ku në dosje të tenderit është kërkuar si dëshmi kopja e këtyre dy certifikatave, autoriteti

g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.